

het nëse përfshihet në veprimtari kriminale, si trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi dhe shfrytëzimi. Respektoni legjislacionin mbi migracionin për qëllime të punësimit në Bashkimin Evropian dhe migroni për qëllime pune vetëm nëse keni një kontratë pune me një punëdhënës.

5. Zgjidh alternativa të qendrueshme

Marra e një diplome universitare, fitimi i aftësive të reja përmes skemave të arsimit dhe formimit profesional, ju ndihmojnë për të rritur mundësinë e punësimit tuaj në Shqipëri dhe jashtë saj. Bursa të ndryshme ofrohen nga qeveria shqiptare përmes Fondit të Ekselencës, ("FONDEX"), apo Erasmus +, programi më i madh i financuar nga BE për arsimin, trajnimin, të rinjtë dhe sportet (<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/>). Gjithashtu Ministria Shqiptare e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, here pas here shpall njoftimet për bursat dhe mundësitë e arsimit të nxënëësve që përfundojnë arsimin e mesëm dhe dëshirojnë të vijojnë studimet e larta apo të ndjekin programe të ndryshme kualifikuese në disa vende të Evropës dhe me gjërë. .

Qëndroni të informuar në ëfaqen e internetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë: <http://ëëë.arsimi.gov.al/al/arsimi/universiteti/bursa-dhe-programe-studimi>.

Nëse jeni të interesuar për të përfituar aftësitë e kërkuara në tregun e punës, regjistrohuni në skemat e Arsimit dhe Formimit Profesional përmes (<http://shkp.gov.al/qendra-formimi-profesional/>) apo Qendrat e Formimit Profesional në zonën tuaj. Regjistrohuni pranë Zyrave vendore të Punësimit dhe përfitoni nga programet e nxitjes së punësimit për të rinjtë, të sapodiplomuarit, jetimët e gratë.

Përfitoni nga ofertat e punës në

www.kerkojpunegov.al;
www.njoftime.com/punel/;
www.duapune.com etj.

Migrim i sigurt në Bashkimin Evropian do të thotë migrim i ligjshëm dhe i informuar, nëse keni një kontratë të rregullt pune. Zhvillimi profesional dhe avancimi në karrierë janë rruga e sigurt drejt mundësive më të mira për punësim në Shqipëri dhe vendet e BE-së.

Migracioni i parregullt dhe azili nuk janë zgjedhja e duhur për një jetë më të mirë në Bashkimin Evropian.



LËVIZJA E LIRË DHE EMIGRIMI I PALIGJSHËM.

Kujdes.

Të dashur qytetarë, përpara se të udhëtoni për në vendet e Bashkimin Evropian, Hollandë apo Belgjikë, njihuni me këto rregulla të përgjithshme:

Nëse udhëtoni për qëllime turizmi ose për të vizituar të afërmit tuaj, rezervimi i hotelit (adresa, nr. i telefonit i personit pritës), bileta e kthimit, si dhe një sasi parash duhet të jetë në dispozicion për deklaram në kufi.

Kur udhëtoni për arsye shëndetësore, duhet të pajiseni me një rekomandim nga institucioni shëndetësor shqiptar, si dhe një konfirmim nga institucioni i huaj shëndetësor.

Nëse udhëtoni për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme zyrtare, sportive apo kulturore, dokumentacioni përkatës për aktivitetin për të cilin jeni të ftuar duhet gjithashtu t'i paraqitet autoriteteve të kufirit.

Jeni nën 18 vjeç dhe dëshironi të udhëtoni në Bashkimin Evropian?

Të miturit nga 12 - 18 vjeç kanë nevojë për të njëjtat dokumente si një i rritur, për të udhëtuar në Bashkimin Evropian, përfshi Holandën dhe Belgjikën. Kërkohet përdorimi i autorizimit prindëror nëse fëmija udhëton vetëm ose në shoqërinë e personave të tjerë. Nëse fëmija udhëton me një nga prindërit e tij, ky prind duhet të marrë një autorizim me shkrim nga prindi tjetër, që mund të vërtetohet nga autoritetet vendore. Gjithashtu prindi i tëë miturit, qëë dëshiron tëë udhëtojëë nëë vendet e BE-sëë, duhet tëë vëëjëë nëë dijeni mëësuesin kujdestar tëë fëëmijëës pëër largimin dhe kohëëzgjatjen e qëëndrimit. Në rast të braktisjes së të miturve në një shtet të BE-së, prindi rrezikon dënimin sipas nenit 124 të Kodit Penal, me gjobë deri në tre vjet ose me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Po planifikoni të migroni në Bashkimin Evropian për punë?

Liberalizimi i vizave ofron mundësi të lëvizjes së lirë për turizëm dhe shkëmbime të shkurtra, por nuk ofron mundësi për punë dhe migrim të rregullt.

Në kuadër të liberalizimit të vizave, shqiptarët janë të lirë të udhëtojnë për 90 ditë gjatë një periudhe 6 mujore pa viza brenda zonës së Shengenit. Nëse ky rregull nuk respektohet, ju rrezikoni të merrni një gjobë prej 600-3000 euro në kufi, dhe në rast se gjoba nuk paguhet, ju refuzohet hyrja në çdo shtet tjetër të zonës Shengen deri në 10 vjet.

Po mendoni të kërkonte azil në një vend të Bashkimit Evropian?

Azili mbi fakte jo të qenësishme, nuk është një instrument që mund t'iu japë mundësi të qëndroni dhe të punoni në Bashkimin Evropian. Shqipëria tashmë është në listën e vendeve të sigurta të origjinës për tetë shtete anëtare të BE-së (Austria, Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Danimarka, Franca, Luksemburgu, Mbretëria e Bashkuar), prandaj ka pak gjasa që të pranohen kërkesat për azil nga shtetasit shqiptarë. Kërkesat për azil mbi fakte jo të qenësishme,

nënshtrohen penalizimit.

Policia e Shtetit Shqiptar ka vënë në dispozicion një bazë të dhënash me rastet e gjakmarrjes për të parandaluar kërkimin e azilit mbi fakte jo të qenësishme, për këtë arsye.

Cilat janë hapat për një migrim të sukseshëm?

1. In formohu

Ju mund të migroni për punë, nëse siguron një kontratë pune me një punëdhënës në një shtet të Bashkimit Evropian. Pyesni para se të merrni vendimin për të migruar. Kontaktoni Sportelet e Migracionit në zonën tuaj dhe Zyrat Vendore të Punësimit për të parë nëse ka ndonjë mundësi për migrim të rregullt në Bashkimin Evropian. Dëgjoni përvojat që kanë patur miqtë tuaj (migrantët e kthyer), OJF-të, autoritetet lokale, të cilat gjithashtu mund t'ju ndihmojnë t'u përgjigjeni pyetjeve tuaja rreth migrimit të rregullt.

2. Kontrolloni agjencinë tuaj të punësimit

Sigurohuni që agjencia e punësimit të jetë e licencuar sipas rregullave. Nëse rekrutuesi ose punëdhënësi juaj, ju kërkon të ndryshoni moshën tuaj ose të punoni pa kontratë, kjo është një shenjë paralajmëruese e shfrytëzimit dhe kontrabandimit. Kjo tregon se punëdhënësi juaj nuk dëshiron të sigurojë punë në mënyrë ligjore dhe mund të planifikojë të përfitojë prej jush. Kërkonte dhe mbani faturat për çdo pagesë të bërë në procesin e rekrutimit dhe migrimit.

3. Martesat jashtë vendit

Nëse merrni një propozim për martesë jashtë vendit, sigurohuni të mos bëni ndonjë hap që mund t'ju kompromentojë të ardhmen.

Nëse ndiheni në rrezik, telefononi 116 006, linjën telefonike kombëtare kundër trafikimit ose përdorni Aplikacionin për celularët smart "Raporto! Shpëto!" që mund ta shkarkoni nga Google Play.

4. Zgjidhni rrugën e ligjshme

Migracioni i parregullt dhe azili nuk janë zgjedhja e duhur për një jetë më të mirë në Bashkimin Evropian. Ju keni shumë më tepër mundësi të merrni mbrojtje nga autoritetet në vendin tuaj të origjinës dhe jashtë vendit, nëse migroni përmes kanaleve ligjore. Migrantët e parregullt janë në rrezik shumë më të madh për t'u shfrytëzuar. Një emigrant i parregullt mund të arrestohet ose të mbahet në një vend të BE-së dhe të deporto-